

### Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë

#### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për janar-maj 2018

#### Zhvillime të tjera

- Zhvillohet takimi i 15-të i Iniciativës së Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për Mbikëqyrjen e Sigurimeve
- AMF, marrëveshje bashkëpunimi me UET për edukimin financiar dhe formimin e studentëve
- Eksperienca sllovene në tregun e sigurimeve
- *Workshop* ndërkombëtar në kuadër të projektit për sigurimet vullnetare gjithëpërfshirëse
- AMF paralajmëron mbi rreziqet e përdorimit të monedhave virtuale me ofertë fillestare (ICO)

#### Publikime

- IAIS publikon Studimin Tematik mbi sigurimet *Index-based Insurances*

#### Edukimi i Konsumatorit

- Kriptomonedhat – “E mira, e keqja dhe e shëmtuara” (pjesa e dytë dhe e fundit)

#### Lajme Ndërkombëtare

- Poloni
- Rusi
- Sllovaki
- Ukrainë

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, gjatë raportimit në Kuvendin e Shqipërisë*

—○○○—  
Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv iu referua vlerësimeve dhe rekomandimeve të institucioneve më të rëndësishme ndërkombëtare për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi prezantoi në datë 21 qershor 2018, në seancë plenare në Kuvendin e Shqipërisë, Raportin mbi aktivitetin e Autoritetit gjatë vitit 2017. Z. Koçi u ndal në zhvillimet dhe arritjet kryesore të vitit të kaluar, ndërsa përmendi disa nga sfidat me të cilat përballet Autoriteti dhe tregjet nën mbikëqyrje.

Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv iu referua vlerësimeve dhe rekomandimeve të institucioneve më të rëndësishme ndërkombëtare për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Z. Koçi theksoi se sfida kryesore e Autoritetit do të jetë transformimi i tregjeve financiare jobankare nga tregjet më të dobëta në rajon në një nga tregjet financiare më të konsoliduara në Ballkanin Perëndimor, me fokus mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-maj 2018

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-maj 2018 kapën vlerën mbi 6.28 miliardë lekë, ose 3.01% më shumë se janar-maj 2017. Gjatë muajit janar-maj 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 462,260 me një rritje prej 7.3% krahasuar me janar-maj 2017.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një ulje me 17.57% në krahasim me periudhën janar-maj 2017. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.33 miliardë lekë, apo 68.33 % të totalit të dëmeve të paguara bruto.

### Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 3.62% gjatë periudhës janar-maj 2018, krahasuar kjo me janar-maj 2017.

### Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 3.81 miliardë lekë gjatë periudhës janar-maj 2018, duke shënuar një rritje prej 7.97% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 60.63% të tregut të sigurimeve.

### Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 12.85% të tregut të Jo-Jetës;
- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 14.07% të tregut të Jo-Jetës.


Gjatë muajit janar-maj 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 462,260 me një rritje prej 7.3% krahasuar me janar-maj 2017.

## Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 5.31% krahasuar me janar-maj 2017. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 64.38% të sigurimit të Jetës.

## Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-maj 2018

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore:



## ZHVILLIME TË TJERA

### Zhvillohet takimi i 15-të i Iniciativës së Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për Mbikëqyrjen e Sigurimeve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi më datë 12 qershor, në Tiranë, takimin e 15-të të Iniciativës për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, CESEE.



*Përfaqësues të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore në takimin e 15-të të Iniciativës për Mbikëqyrjen e Sigurimeve*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi më datë 12 qershor, në Tiranë, takimin e 15-të të Iniciativës për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, CESEE. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse të sigurimeve nga vende si Bosnje-Hercegovina dhe Republika Serbe e Bosnjës, Hungaria, Kroacia, Republika e Kosovës, Mali i Zi, Maqedonia, Republika Çeke, Polonia, Sllovakia dhe Shqipëria.

Takimi u drejtua nga Z. Peter Braumüller, Drejtor Ekzekutiv në FMA e Austrisë, Përgjegjës për Mbikëqyrjen e Shoqërive të Sigurimit dhe Fondeve të Pensionit. Drejtori Ekzekutiv në FMA, Z. Braumüller, vlerësoi jetëgjatësinë e kësaj Initiative që ka lindur në vitin 2011. Takimi, theksoi Z. Braumüller, zhvillohet 2 herë në vit duke formalizuar komunikimet e rregullatorëve të mbikëqyrjes së sigurimeve në rajon për shkëmbimin e eksperiencave dhe informacioneve, si edhe përballimin e sfidave që nxjerrin zhvillimet e tregut.

Duke përshëndetur takimin, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi, pasqyroi zhvillimet dhe ecurinë e tregut të sigurimeve në Shqipëri dhe theksoi se AMF ka hartuar edhe një Strategji 5-vjeçare zhvillimi për tregjet nën mbikëqyrje. Edhe pse tregu i sigurimeve ende mbetet i orientuar nga produktet e detyrueshme të sigurimit, AMF bën përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen në produktet vullnetare të sigurimeve.



Gjatë sesioneve pati diskutime dhe shkëmbime të eksperiencave për të gjitha tematikat nga autoritetet mbikëqyrëse të vendeve pjesëmarrëse në takim. Takimi i ardhshëm i iniciativës CESEE të mbikëqyrjes në sigurime do të bëhet në tetor 2018.

Takimi u zhvillua në katër sesione tematike:

- Kriteret dhe sfidat në zbatimin e standardeve të përshtatshmërisë (*fit and proper*) për mbajtësit e posteve të rëndësishme në shoqëritë e sigurimit, e cila u prezantua dhe moderua nga Znj. Tanja Denic e Autoritetit Kroat të Mbikëqyrjes Financiare;
- Si të reduktohet përqendrimi i sigurimeve të detyrueshme motorike në tregun e sigurimeve, për vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Kjo temë u prezantua dhe moderua nga Znj. Marsela Vaska, Drejtore e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve;
- Menaxhimi i cilësisë dhe aktivitetet kontrolluese mbi kanalet e shpërndarjes në kompanitë e sigurimeve në kuadër të direktivës së re IDD (*Insurance Distribution Directive, IDD*) e cila u prezantua dhe moderua nga Katerina Vichova, inspektore e mbikëqyrjes në vend (*on-site*) pranë Bankës Kombëtare të Republikës Çeke;
- Sistemet e vlerësimit të riskut për qëllime rregullatorë, temë e cila u prezantua dhe më pas sesioni u moderua nga Dritan Varfi, Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Riskut pranë AMF-së.

Gjatë sesioneve pati diskutime dhe shkëmbime të eksperiencave për të gjitha tematikat nga autoritetet mbikëqyrëse të vendeve pjesëmarrëse në takim. Takimi i ardhshëm i iniciativës CESEE të mbikëqyrjes në sigurime do të bëhet në tetor 2018.

### **AMF marrëveshje bashkëpunimi me UET për edukimin financiar dhe formimin e studentëve**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më datë 7 qershor 2018, një takim me përfaqësues të Universitetit European të Tiranës (UET), i cili u pasua nga nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi.

Të pranishëm në takim ishin Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi, Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtoresha Ekzekutive e AMF-së dhe drejtues të tjerë të Autoritetit, ndërsa UET përfaqësohej nga Z. Adrian Civici, President i UET, Z. Selami Xhepa, Dekan i Fakultetit të Ekonomisë dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Znj. Ermela Kripa, Shefe e Departamentit të Financës.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së theksoi se bashkëpunimi me UET do t'i shërbejë një prej prioriteteve të Autoritetit për edukimin financiar të publikut e në veçanti të studentëve, si edhe rritjes së aftësisë së tyre profesionale. Z. Koçi deklaroi se Autoriteti është shumë i angazhuar në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe rritjes së besimit në tregjet nën mbikëqyrje.



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Presidenti i UET Z. Adrian Civici, gjatë nënshkrimit të marrëveshjes*

Në vitin e ri akademik, ekspertët e AMF-së dhe profesionistët nga fusha të ndryshme të tregjeve financiare jobankare do të zhvillojnë leksione të hapura në UET dhe studentët do të kenë mundësinë e realizimit të internshipeve pranë Autoritetit.

Ndërsa Presidenti i UET, Z. Adrian Civici theksoi se marrëveshja e bashkëpunimit pritet të realizojë një nga objektivat e vendosur që studentët të mos kenë vetëm një diplomë formale, por që t'i përgjigjen më së miri kërkesave të tregut të punës. Z. Civici deklaroi se UET po i përshtat programet e studimit, duke i orientuar studentët drejt profileve të specializuara, që janë ndër të tjera edhe për tregjet financiare jobankare (tregun e sigurimeve apo tregun e kapitalit).

UET ka ndërtuar Projektin "250+", i cili krijon një lidhje të programeve të studimit, sidomos atyre të ciklit të dytë të studimit me nevojat që ka tregu i punës dhe institucionet.

Në vitin e ri akademik, ekspertët e AMF-së dhe profesionistët nga fusha të ndryshme të tregjeve financiare jobankare do të zhvillojnë leksione të hapura në UET dhe studentët do të kenë mundësinë e realizimit të internshipeve pranë Autoritetit.

AMF dhe UET do ta thellojnë bashkëpunimin edhe përmes organizimit të konferencave shkencore, apo aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe edukuese për studentët.

AMF ka lidhur marrëveshje të ngjashme me universitete të tjera në zbatim të strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit për tregjet nën mbikëqyrje, duke zhvilluar aktivitete dhe konferenca të ndryshme.

## Eksperiencia sllovene në tregun e sigurimeve

Eksperiencia sllovene në tregun e sigurimeve u prezantua në një takim me përfaqësues të tregut shqiptar të sigurimeve, tregut bankar dhe atij të mikrofinancës, të shoqatave të bujqësisë dhe turizmit, që veprojnë në vend. Tryeza e diskutimit u zhvillua me 13 qershor 2018 e organizuar në bashkëpunim midis Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë dhe asaj të Sllovenisë.



*Gjatë zhvillimit të takimit*

—○○○—  
Eksperiencia sllovene në tregun e sigurimeve u prezantua në një takim me përfaqësues të tregut shqiptar të sigurimeve, tregut bankar dhe atij të mikrofinancës, të shoqatave të bujqësisë dhe turizmit, që veprojnë në vend.

Kryetari i Bordit të AMF-së, Z. Pajtim Melani vlerësoi bashkëpunimin e nisur midis dy shoqatave për një nga tregjet më të zhvilluara në rajon dhe shprehu bindjen se ky takim përbën një hap të sigurt drejt zgjerimit dhe konsolidimit të mëtejshëm të këtij tregu.

Drejtorja Ekzekutive e Shoqatës Sllovene të Sigurimeve, Zj. Maja Krumberger dhe kolegët e saj sollën përvojën e tregut slloven në fushën e sigurimeve, duke u ndalur veçanërisht në aspekte të veçanta të tij siç janë sigurimet në bujqësi, në turizëm dhe në shëndetësi.

Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë dhe Shoqata Sllovene e Sigurimeve nënshkruan dhe Marrëveshje Bashkëpunimit, e cila do të sjellë mundësinë e shkëmbimit të mëtejshëm të eksperiencave midis dy vendeve në tregun e sigurimeve.



## **Workshop ndërkombëtar në kuadër të projektit për sigurimet vullnetare gjithëpërfshirëse**

Në kuadër të projektit për sigurimin vullnetar gjithëpërfshirës, në datat 19-22 qershor 2018 u zhvillua në Durrës *workshopi* ndërkombëtar "Inovation Incubator". Projekti mbështetet dhe financohet nga Iniciativa për Akses në Sigurime (Access to Insurance Initiative) në bashkëpunim me Akademinë për Udhëheqje Globale të GIZ (GIZ Global Leadership Academy) dhe përfundon në nëntor 2018.



*Gjatë zhvillimit të workshopit për sigurimet vullnetare gjithëpërfshirëse*

Në kuadër të projektit për sigurimin vullnetar gjithëpërfshirës, në datat 19-22 qershor 2018 u zhvillua në Durrës *workshopi* ndërkombëtar "Inovation Incubator".

Pjesëmarrës në këtë *workshop* ishin ekipet e vendeve të përfshira në projekt Mongolia, Gana, Kenia dhe Shqipëria me drejtues departamentesh të rëndësishme nga shoqëritë e sigurimit, banka, agjenci kreditimi, autoritete mbikëqyrëse si edhe organizma të tjerë në fushën financiare dhe të biznesit. Ekipet e vendeve ideuan mënyra inovative me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së individëve dhe bizneseve të vogla në skema të sigurimeve vullnetare gjithëpërfshirëse.

## **AMF paralajmëron mbi rreziqet e përdorimit të monedhave virtuale me ofertë fillestare (ICO)**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ka paralajmëruar edhe më parë mbi mundësinë e operimit të skemave mashtruese piramidale duke përdorur emetimet e monedhave virtuale me ofertë fillestare apo të ashtuquajtura (ICO). Në kuadrin e edukimit financiar Autoriteti paralajmëron investitorët të tregojnë shumë kujdes, pasi emetimi i monedhave virtuale me ofertë fillestare (ICO), si rregull nuk është subjekt i ndonjë forme rregullimi dhe, rrjedhimisht, nuk është subjekt mbikëqyrjeje.

Këto lloj instrumentesh së bashku me zhvillimet e fundit në teknologjinë financiare mund të përdoren për të promovuar apo nxitur edhe zhvillimin e skemave mashtruese piramidale apo Ponzi. Në këto kushte, investitori nuk gëzon të njëjtin nivel mbrojtjeje sikurse në rastin e produkteve financiare të ofruara nga subjekte të licencuara dhe të mbikëqyrura.

## Çfarë janë në përgjithësi skemat piramidale apo Ponzi

Një skemë piramidale/Ponzi është një investim mashtrues, promovuesi i të cilit premtion pagesën e fitimeve të caktuara investitorëve ekzistues duke përdorur fondet që sigurohen nga kontributet e investitorëve të rinj. Organizuesit e këtyre skemave shpesh herë, mashtrojnë investitorët duke u premtuar, se mund të investojnë fondet e tyre në mundësi investimi të cilat premtojnë fitime të larta, me pak ose aspak rrezik.

Në shumë skema piramidale/Ponzi, shpesh herë në vend që të angazhohen në aktivitet të ligjshëm investues, mashtruesit fokusohen në tërheqjen e fondeve të reja për të paguar investitorët e vjetër.

Ashtu si ndodh shpeshherë, organizuesit e këtyre skemave mund të përdorin inovacionet e fundit teknologjike, për të nxitur investitorët dhe për t'u premtuar atyre fitime të larta. Rritja e përdorimit të monedhave virtuale në tregjet globale mund të nxisë mashtruesit të tërheqin investitorët në skema Ponzi/piramidale, duke i nxitur ata të investojnë në kriptomonedha të caktuara, si për shembull në kriptomonedha që dalin për herë të parë në treg (ICO), por jo vetëm. Këto skema zakonisht premtojnë kthime të larta si mundësi për tu futur të parët në një industri që po rritet shumë shpejt.

Ashtu si ndodh shpeshherë, organizuesit e këtyre skemave mund të përdorin inovacionet e fundit teknologjike, për të nxitur investitorët dhe për t'u premtuar atyre fitime të larta.



### Kujdes!

Investimi në një monedhë virtuale me ofertë fillestare, (ICO) mund të rezultojë si investim në një skemë mashtruese. Të gjitha këto skema kanë disa karakteristika të përbashkëta si:

#### 1. Deklarojnë fitime të larta duke mos përmendur rrezikun e investimit

Në fakt, investimet që ofrojnë fitime të larta zakonisht kanë më tepër rrezik për investitorët. Të gjithë investitorët kur marrin vendimin për të investuar diku, janë të ekspozuar ndaj rrezikut mbi humbjen e parave të tyre.

Në një emetim të mirëfilltë të letrave me vlerë, emetuesi është i detyruar t'i paraqesë investitorëve një dokument që quhet "Prospekt", i cili përmban informacion të detajuar në lidhje me emetimin si dhe rreziqet që shoqërohen nga investimi në atë instrument.

## 2. Deklarojnë fitime të qëndrueshme dhe të vazhdueshme

Të gjitha investimet karakterizohen si rregull nga luhatshmëria, sidomos investimet me një shkallë të lartë kthimi kanë luhatshmëri më të lartë. Investimet, të cilat premtojnë kthime të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, pavarësisht ndryshimeve të kushteve të tregut, mbartin rrezikun të rezultojnë në investime mashtruese.

## 3. Ofrojnë komisione për të tërhequr njerëz të rinj në skemë

Shumë skema Ponzi/Piramidale mund të paguajnë komisione shtesë ndaj një investitori me qëllim që ai të tërheqë njerëz të tjerë në skemë. Ojektiv i tyre është rritja e pjesëmarrjes në skemë, në mënyrë që me fondet e investitorëve të rinj të paguhen investitorët më të vjetër në skemë. Duhet të jeni shumë skeptikë kur ju bëhen oferta të tilla, pasi mund të bëheni pjesë e skemës.

## 4. Strategji komplekse të investimeve

Është e rekomandueshme të hiqni dorë nga investime të cilat nuk i kuptoni ose për të cilat mund të mos ju jepet një informacion i plotë.

## 5. Probleme me dokumentacionin

Kini kujdes kur ju premtojnë një investim, por ju justifikohen me arsyen se ju nuk mund të shihni të gjithë informacionin mbi investimin. Kërkoni një informacion me shkrim të plotë dhe të detajuar. Në një emetim të mirëfilltë të letrave me vlerë, emetuesi është i detyruar t'i paraqesë investitorëve një dokument që quhet "Prospekt", i cili përmban informacion të detajuar në lidhje me emetimin si dhe rreziqet që shoqërohen nga investimi në atë instrument. Në rastet e (ICO), ky dokument shpeshherë mungon.

## 6. Vështirësi në marrjen e pagesave

Të jeni dyshues kur nuk paguheni në kohën e përcaktuar sipas parashikimit, ose kur keni vështirësi për të dalë nga investimi. Promovuesit e skemave piramidale shpeshherë i inkurajojnë viktimat të mos dalin nga investimet e tyre, duke premtuar fitime akoma më të larta, në qoftë se ata i riinvestojnë fondet e tyre.

## **PUBLIKIME**

IAIS publikon Studimin Tematik mbi sigurimet *Index-based Insurances*, lidhur me Tregjet e Sigurimeve Gjithëpërfshirëse (*Inclusive Insurance Markets*)

*Index-based Insurances* apo sigurimet me indeksim janë kontrata sigurimi në të cilat dëmi përcaktohet duke ju referuar një indeksi të përcaktuar më parë. (shpesh i cilësuar si indeksi parametrik). Përgjithësisht *Index-based Insurances* po shihen gjithnjë e më shumë si një mënyrë për të menaxhuar katastrofat dhe fatkeqësitë natyrore, për të mbështetur sigurinë e ushqimit dhe për të rritur aksesin në sigurime.

Ky Studim Tematik për *Index-based Insurances* përshkruan praktikatat më të mira, për këtë produkt, jep shembujt aktualë si edhe identifikon çështje dhe sfida të lidhura me rregullatorët.

Fokusi kryesor në këtë punim tematik lidhet me çështjen e sigurimit ndaj ngjarjeve të motit dhe katastrofave. Lidhur me këtë në botim janë trajtuar:

- Mënyra se si produkti është dizajnuar si një produkt mikro apo makro dhe si ndikon ai tek mbajtësi i policës së sigurimit;
- Roli i aktorëve të ndryshëm në tregun e sigurimeve nga fatkeqësitë natyrore, sidomos i atyre që janë jo tradicionalisht në këtë segment të tregut siç janë agjencitë shtetërore, ministritë e bujqësisë, agjencitë e përfshira në grumbullimin dhe publikimin e të dhënave statistikore, donatorët dhe sponsorët;
- Siguria juridike, interesi i siguarit si dhe natyra e produktit të sigurimit;
- Çështjet që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit, duke përfshirë zhvillimin e produktit dhe rëndësinë e shqyrtimit të duhur të rrezikut bazë, vendosjen e një indeksi të shëndoshë dhe të besueshëm dhe rolin e subvencioneve.

Materialin më të plotë e lexoni në linkun më poshtë:  
<https://www.iaisweb.org/news/iais-publishes-issues-paper-on-index-based-insurances>

## Kriptomonedhat – “E mira, e keqja dhe e shëmtuara”

*Iniciativa Paraja 20/20 (Money20/20) lindi pasi industria kishte nevojë për një hapësirë ku njerëz të mençur, krijues dhe ambiciozë të lidhen dhe të krijojnë së bashku. Money20/20 është hapësira - ku zhvillohet një radhë takimesh nga teknologji tek paraja tek njerëzit, më pas idetë dhe deri sa idetë bëhen realitet.*

*Money 20/20 është vendi ku ekosistemi i Pagesave, Teknologjisë Financiare (FinTech) dhe Shërbimeve Financiare bashkohen për të eksploruar mënyrat në të cilat konsumatorët dhe bizneset menaxhojnë, shpenzojnë dhe marrin hua parane. Pjesë e këtij rrjeti janë drejtues të lartë ekzekutivë të kompanive të fuqishme të cilët bashkohen për të drejtuar ndryshimet që do të ndodhin në të ardhmen e parasë.*

*Iniciativa Money 20/20 ka filluar në vitin 2012 dhe ajo është shtrirë edhe në vende të tjera. Money 20/20 në Azi ka nisur në mars 2018.*

*Marrë me shkurtime është fjala e Z. Ravi Menon, Drejtor Administrativ i Autoritetit Monetar të Singaporit - Monetary Authority of Singapore (MAS), në “Money 20/20”, Singapor, 15 mars 2018.*

*(Pjesa e dytë dhe e fundit)*

### Menaxhimi i rreziqeve

Një rast i zakonshëm i përdorimit të kriptomonedhave është pagesa. Por a bën kjo që ato të mund të quhen para? Nga leksionet tona të hershme të ekonomisë, paraja shërben për tri funksione: si një mjet shkëmbimi, si ruajtje e vlerës dhe njësi llogaritëse.

Sfida kryesore me të cilat përballen bankat qendrore dhe rregullatorët është kjo: Si mund të shfrytëzojmë potencialin transformues të teknologjisë *blockchain* dhe të kriptomonedhave duke marrë parasysh rreziqet që ato sjellin me vete?

Deri më tani, Autoriteti Monetar i Singaporit, MAS, ka zgjedhur të mos i rregullojë në mënyrë direkte kriptomonedhat. Por ne jemi:

- Fokusuar mbi aktivitetet që lidhen me kriptomonedhat;
- Duke vlerësuar llojet e ndryshme të rreziqeve që paraqesin këto aktivitete; dhe
- Duke marrë parasysh përgjigjet e përshtatshme rregullatorë;
- Duke u përpjekur të sigurojmë që të mos e ndryshim inovacionin.

Rreziqet kryesore që MAS po monitoron tek kriptomonedhat janë në fushat e stabilitetit financiar, pastrimit të parave, mbrojtjes së investitorëve dhe funksionimit të tregut.

Nga leksionet tona të hershme të ekonomisë, paraja shërben për tri funksione: si një mjet shkëmbimi, si ruajtje e vlerës dhe njësi llogaritëse.



## Stabiliteti financiar

MAS dhe rregullatorë të tjerë po studiojnë lidhjen midis kriptomonedhës dhe sistemit financiar për të vlerësuar si transmetohen risqet tek stabiliteti financiar.

- Risku i tregut nga një ekspozim i drejtpërdrejtë i institucioneve financiare tek kriptomonedhat;
- Risku i kreditit nëpërmjet huasë së pasigurt në bizneset që kanë objekt të tyre kriptomonedhat;
- Instrumentet financiare të nevojshme, kur huamarrësit premtojnë kriptomonedha si kolateral për të marrë hua dhe për të blerë më shumë kriptomonedha.

MAS vlerëson se natyra dhe shkalla e veprimtarive të kriptomonedhave në Singapor nuk shfaq ndonjë rrezik shqetësues për stabilitetin financiar. Megjithatë, kjo situatë mund të ndryshojë, prandaj ne po e studiojmë këtë aspekt nga afër.

Duke pasur parasysh boshllëqet në burimet tradicionale të informacionit, MAS po shqyrton disa mënyra jokonvencionale për mbledhjen e të dhëna për shkallën dhe fushëveprimin e aktiviteteve lidhur me kriptomonedhat.

- Së pari, vetë kriptomonedhat apo *blockchain* mund të ofrojnë një mori informacionesh duke përfshirë informacion të koduar rreth kohës së përdorimit, adresat e marrësit dhe dërguesit;
- Së dyti, ndërfaqet e Programimit të Aplikimit ose API të ofruara nga kriptomonedhat e pranishme, paraqesin njohuri në kohë reale në rrjedhat aktuale në këmbimet e kriptomonedhave.

## Pastrim parash

Një rrezik i qartë i paraqitur nga disa veprimtari të kriptomonedhave ka të bëjë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

- Ndërmjetësuesit që merren me kriptomonedhat janë të detyruar të raportojnë, në rast të ndonjë transaksioni të dyshimtë, pranë Departamentit të Çështjeve Tregtare;
- Përveç kësaj, projektligji i propozuar i Shërbimit të Pagesave do të kërkojë ndërmjetësuesve që blejnë, shesin ose shkëmbejnë valuta virtuale, të adresojnë në mënyrë specifike pastrimin e parave dhe reziqeve për financimin e terrorizmit;
- Ndërmjetësuesve do t'u kërkohej të aplikojnë vigjilencën e duhur tek konsumatorët dhe të kryejnë kontrollet dhe proceset në përpjesëtim të drejtë me rreziqet e tyre.

Një rrezik i qartë i paraqitur nga disa veprimtari të kriptomonedhave ka të bëjë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

## Mbrojtja e investitorëve

Mbrojtja e investitorëve është një tjetër shqetësim i menjëhershëm që buron nga mania e kriptomonedhave. Kur kriptomonedhat përfaqësojnë pronësinë ose një interes mbi pasuritë e një emetuesi ose çdo pasuri, apo një borxh që i detyrohet emetuesit, atëherë ato mund të konsiderohen si letra me vlerë bazuar në aktet ligjore të Letrave me Vlerë dhe Kontratave me shitblerje në të ardhmen (*Futures*).

Kjo do të thotë që:

- Emetuesit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e prospekteve përpara ofrimit të këtyre argumenteve;
- Ndërmjetësit që merren me të tilla monedha duhet të plotësojnë kërkesat e licencimit;
- Platformat që lehtësojnë tregtimin sekondar të kriptomonedhave duhet të miratohen ose të njihen nga MAS.

Lidhur me investitorët, prioritet i MAS ka qenë që t'i bëjë ata të vetëdijshëm për rreziqet që sjell vendosja e parave të tyre në kriptomonedha:

- Ne kemi këshilluar publikun që të veprojë me kujdes të veçantë nëse ata duan të investojnë në kriptomonedha;
- Ata mund të humbin të gjithë pasurinë e tyre, nëse bien çmimet;
- Ata nuk kanë mbrojtje nga ana e rregullatorëve, nëse ka skema mashtruese.

## Funksionimi i tregut

Ekziston edhe çështja e integritetit të tregut dhe funksionimit të tij. Disa platforma këmbimesh të kriptomonedhave jashtë vendit kanë pasur sulme kibernetike dhe si pasojë vjedhje të këtyre kriptomonedhave. Ka edhe zëra dhe raporte për manipulim të shfrenuar të tregut dhe mashtrime të tjera në veprimtarinë e platformave të këmbimit të kriptomonedhave.

Ne jemi duke parë me interes zhvillimet në SHBA, ku kontratat me shitblerje në të ardhmen referuar kriptomonedhave (*Futures*) janë prezantuar në bursat e rregulluara. Parë nga perspektiva e integritetit të tregut, këtu mund të ketë disa përparësi:

- Këto platforma këmbimi kanë rregulla të qarta për drejtimin e veprimtarive të tregtimit dhe post-tregtimit;
- Këto produkte gjithashtu mund të kenë një ndikim stabilizues mbi çmimet e kriptomonedhave pasi ato sigurojnë mënyra mbrojtëse të dyanshme për investitorët.

Disa platforma këmbimesh të kriptomonedhave jashtë vendit kanë pasur sulme kibernetike dhe si pasojë vjedhje të këtyre kriptomonedhave.

Por rregullorja nuk mund të adresojë të gjitha shqetësimet rreth kriptomonedhave. Industria duhet gjithashtu të luajë rolin e saj në forcimin e ekosistemit, për shembull, duke miratuar praktikat më të mira rreth transparencës, sigurinë kibernetike dhe ruajtjen e të dhënave.

### Mbrojtja nga Ligji i Gresham-it

Ajo çfarë u shpjegua më sipër, e mira, e keqja dhe e shëmtuara e kriptomonedhave, janë në fakt cilësi që merren nga përdorimi i duhur ose jo i kriptomonedhave. Ashtu si Paraja, kriptomonedhat mund të jenë një forcë për të mirën apo për të keqen. Të mos harrojmë, paraja nuk është rrënja e të gjitha të këqijave, por e keqja qëndron tek etja për paranë. E njëjta gjë vlen edhe për kriptomonedhat - magjie lidhur me këto monedha, si një mënyrë për të fituar para në mënyrë të shpejtë dhe abuzimi në aktivitete të paligjshme, kjo është baza e shqetësimeve tona.

Ekziston një aksiomë e lashtë në ekonomi e quajtur Ligji i Greshamit, i cili interpretohet si “Paraja e keqe nxjerr jashtë të mirën”.

- Ne duhet të bashkëpunojmë me rregullatorët dhe industrinë e kriptomonedhave për të siguruar që paraja e keqe mos të marrë fuqinë.
- Dhe se një epokë e re e kriptomonedhave po shfrytëzon potencialin e teknologjisë *blockchain* për të mirën sociale duke zbutur rreziqet që paraqesin monedhat e sotme.

Kjo është një e ardhme që duhet të jetë e sigurt dhe shpresoj se disa nga talentet e pranishëm në këtë sallë do të ndihmojnë në realizimin e saj.

Ekziston një aksiomë e lashtë në ekonomi e quajtur Ligji i Greshamit, i cili interpretohet si “Paraja e keqe nxjerr jashtë të mirën”.

## Sllovakia, Parlamenti miraton ligjin për taksën e sigurimeve

[www.xprim.com](http://www.xprim.com)

Parlamenti në Sllovakia ka miratuar një ligj për taksën e re të përgjithshme 8% të sigurimeve. Ligji do të hyjë në fuqi më 1 janar 2019. Taksa e re do të zëvendësojë tarifën aktuale 8% në të gjitha segmentet e sigurimit të Jo-Jetës. Përfundimisht nga kjo bëjnë sigurimet e detyrueshme, ku tarifa do të ruhet dhe do të shtohet taksa prej 8%. Siguruesit do të jenë të detyruar të njoftojnë klientët për çdo ndryshim të primit të sigurimit, 10 javë përpara skadimit të afatit të kontratës aktuale, për t'i dhënë kohë të mjaftueshme klientëve për të vendosur nëse do t'i pranojnë apo jo çmimet e reja. Taksa e re vlerësohet t'i sjellë rreth 36 milionë euro në vit buxhetit të shtetit. Taksa u kundërshtua nga kompanitë e sigurimit, me argumentin se çënon tregun. Por sipas Ministrisë së Financave të Sllovakisë, taksa është një standard i BE-së dhe klientët e shoqërive të sigurimit nuk pritet të përballen me ndryshime të çmimeve. Taksa do të paguhet nga siguruesit dhe kjo nuk do të sjellë rritje të çmimeve të kontratave të sigurimit, argumenton Ministria e Financave.

## Poloni, dixhitalizimi u vjen në ndihmë shoferëve

[www.xprim.com](http://www.xprim.com)

Në Poloni, drejtuesit e makinave nuk do të jenë të detyruar të mbajnë certifikatën e regjistrimit të mjetit dhe policën e sigurimit të përgjegjësive civile. Rregullorja e re hyn në fuqi më 1 tetor 2018. Nga kjo datë për të realizuar kontrollin e mjetit, drejtuesit do t'i kërkohet vetëm leja e drejtimit. Të gjitha të dhënat e tjera do të kontrollohen online nëpërmjet Rregjistrimit Qendror të Mjeteve, ku ka informacione për certifikatën e regjistrimit, si edhe për sigurimin e mirëmbajtjes së mjetit. Ky rregull nuk do të aplikohet për mjetet e regjistruara jashtë vendit.

## Rusi, huliganizmi dhe terrorizmi rriten primet e sigurimit

[www.xprim.com](http://www.xprim.com)

Gjatë Kampionatit Botëror të futbollit në Rusi, rreziku i sulmeve terroriste dhe dëmeve nga huliganët kanë ndikuar në rritjen e primeve të sigurimit për bizneset dhe lojtarët. Këto prime janë rritur më tepër krahasuar me atë që ndodhi 4 vite më parë në Brazil. Brokerat dhe siguruesit vlerësojnë se vlera e primeve të sigurimit është mbi 10 miliardë dollarë. Primet për sulmet terroriste janë rreth 10% më të larta sesa në Botërorin e kaluar. Pronarët e stadioneve, agjentët e biletave, kompanitë e kateringut dhe lojtarët janë mes të siguruarve për rreziqe që përfshijnë anulimin, rrëmbimin, sulmet kibernetike apo dëmtimet personale. Sipas vlerësimeve, 12 stadiumet, nga Yekaterinburg në lindje te St Petersburg në veri, Kaliningradi në perëndim te Sochi në jug, janë siguruar për dëmtim fizik në shumën e rreth 1 miliardë dollarëve. Një shumë prej 250 milionë dollarë është sigurimi për aktet terroriste dhe rreth 100 milionë dollarë për ngjarje të ndryshme me një agresor. FIFA si organizator ka paguar 134 milionë dollarë siguracion për klubet, lojtarët e të cilëve dëmtohen.

## Ukrainë, pritet rritje e tarifave për siguracionin TPL

[www.xprim.com](http://www.xprim.com)

Presidiumi i Byrosë së Sigurimeve në Ukrainë synon të rrisë tarifën për sigurimin motorik ndaj palëve të treta (TPL). Raportohet se frekuenca e ngjarjeve të sigurimit në Ukrainë është rritur gradualisht, ashtu si edhe humbjet nga kjo kategori sigurimi. Për këtë arsye, në vitin 2019 siguruesit do të çojnë primet në maksimumin e lejuar nga ligji. Megjithatë, ekspertët paralajmërojnë se një masë e tillë nuk do të ndihmojë për të përballuar pagesën e dëmeve gjithnjë në rritje. Drejtori i Përgjithshëm i Shoqatës së Siguruesve në Ukrainë, Vyacheslav Chernyakhovsky, pretendon se në periudhën 2015-2017 ka një rritje me 35-40% të pagesës së dëmeve për sigurimin motorik ndaj palëve të treta. Kjo shpjegohet me hyrjen në vend të një numri gjithnjë e më të madh makinash. Tarifat u rritën për herë të fundit në vitin 2010.





---

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)